



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 05 maj 2023  
Kodi i ZRRE-së: V\_1736\_2023

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafit 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.11, Nenit 30 dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 32 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës **31.03.2023** për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike, të bërë nga ndërmarrja **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** me adresë: Rr. Vicianum Nr.23, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 05 Maj 2023 nxori këtë:

## **VENDIM**

- I. I LËSHOHET LICENCA** për Furnizim me shumicë (tregtim) të Energjisë Elektrike ndërmarrjes **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** (Eurosol&Energy LTD, emri tregtar) me numër Licence ZRRE/Li\_89/23, për periudhën kohore prej pesë (5) vitesh dhe do vlejë nga **15.05.2023** deri **14.05.2028**.
- II. Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

## **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë **31.03.2023** ka pranuar nga përfaqësues të ndërmarrjes **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike në Kosovë.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** me datë **05.05.2023** ka njoftuar përmes gazetës (portaleve në mungesë të gazetave) palët e interesit se ka dorëzuar në Rregullator Aplikacionin për licencim të aktivitetit të furnizimit me shumicë (tregtimit) të energjisë elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë



aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë (potal). Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.

- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- Licenca e lëshuar sipas këtij Vendimi do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive të tjera të bashkëngjitura aplikacionit të ndërmarrjes **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Ky vendim dhe Licenca Nr **ZRRE/Li\_89/23** i dërgohet:

- Ndërmarrjes **Eurosol&Energy LTD SH.P.K** dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i Rregullatorit:**

  
Ymer Fejzullahu, kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Gani Buçaj, anëtar